

të gjithë familjarët e Ismailit u larguan nga qyteti dhe shkuan në Astrazup/Ostrozub [Malishevë/Mališevo], por ai ndenji në **Rahovec/Orahovac**. Nga ora 16:00, më **20.07.1998**, kushëriri i Ismailit, Iliu, dhe dy banorë e panë trupin e pajetë të Ismailit. Ishte i shtrirë në pragun e butikut të tij, ndërkaq nga butiku dëgjoheshin zërat në gjuhën serbe. Pas pak, pranë butikut u ndal një kamion me ceradën e kuqe. Policët e futën trupin e Ismailit në një qese të zezë najloni dhe e ngarkuan në kamion. Kur familjarët u kthyen pas gjashtë javësh në qytet, e gjetën shtëpitë dhe butikun të shkruar. Në oborr dhe në të gjitha muret e mbetura të shtëpive të djegura kishte gjurmë të plumbave, flokëve dhe gjakut. Familjarët kurrë nuk kanë mësuar çfarë ka ndodhur me trupin e Ismailit. Në regjistrin e të zhdukurve të administruar nga KNKK-ja, lënda e tij e mban numrin BLG-804306-01.

Burimet: deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata N.R, FDH-34337; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795; LBI, *Preliminar..*, FDH-3631; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

Fahredin (Mahmut) Hoxha

(7.04.1930, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, vozitës, tre fëmijë)

Fahredini jetonte në qendër të qytetit, në rrugën *Miladin Popović* numër 156 [**Rahovec/Orahovac**]. Në datën **20.07.1998**, tre policë në uniforma me ngjyrë të zezë dhe me kokat të lidhura me shamia të zeza, erdhën në oborrin e Fahredinit. Ka qenë vetëm në shtëpi, sepse familjarët e tij ishin arratisur më herët nga qyteti. E gjetën Fahredinin në oborr, e morën në pyetje për pak dhe, pastaj, e qëlluan me një plumb në ballë. Kur familjarët e Fahredinit u kthyen në shtëpi më 23.07.1998, e gjetën kufomën e tij në oborr. Po atë ditë, kanë ardhur punëtorë të ndërmarrjes komunale dhe e kanë bartur kufomën e Fahredinit në drejtim të panjohur. Rasti i tij i zhdukjes është evidentuar në regjistrin e KNKK-së me numër BLG-804733-01.

Burimet: deklarata N.N, FDH-850; deklarata

N.N, FDH-879; deklarata O.S, FDH-12938; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795.

Ali (Mehmed) Spahiu

(23.06.1932, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, shtatë fëmijë)

Aliu me motrën Zylfijen ndenjen në shtëpi, kur bashkëshortja e Aliut me djemtë dhe familjarë të tjerë e braktisën qytetin ditën e diel, më 19.07.1998. Që të dy u fshehën në bodrum. Në datën **21.07.1998**, Aliu doli për një çast që të merrte pak ujë. Menjëherë pasi doli, Zulfija i dëgjoi disa zëra dhe, më pas, edhe të shtëna. Po atë ditë, në shtëpi u kthye djali i Aliut, Nesemi, për të parë çfarë kishte ndodhur me të atin dhe hallën. Në oborr, e ka gjetur trupin e Aliut të vrrarë. Për shkak të të shtënave të njëpasnjëshme u largua shpejt nga oborri, por, para largimit, e mbuloi me batanije trupin e të të atit. Të nesërmen, në shtëpi u kthye djali i dytë i Aliut, Mehmedi. Ai e mori me vete hallën Zylfije. Të atin e ka varrosur më 22.07.1998, në afërsi të rrugës në *Mëhallën Sylka*, ku Aliu prehet edhe sot.

Burimet: deklarata N.N, FDH-852; deklarata N.N, FDH-853; deklarata Xh.B, FDH-863; deklarata N.N, FDH-879; deklarata M.S, FDH-33631; KMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; deklarata A.LI, FDH-33491; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Sylejman (Sadik) Cana

(14.04.1939, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Sylejmani me bashkëshorten Fatimen jetonin vetëm. Dy djemtë i kishin në Angli, ndërkaq dy vajza i kishin të martuara. Pas përkeqësimit të situatës së sigurisë, Fatimja e braktisi qytetin së bashku me familjen e mikeshës, Selvishahe Sokoli, përderisa Sylejmani ndenji në shtëpi. Përpos tij, aty këtu nëpër shtëpitë e komshinje kanë mbetur edhe disa persona të moshuar. Bashkëshorti i Selvishahe, Qazimi, para se të braktiste **Rahovecin/Orahovac**, më **21.07.1998**, e kishte parë Sylejmanin. Fatimja u kthye në qytet në fillim të gushtit. E ka gjetur shtëpinë e vet të demoluar dhe